



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Page | 1

VENDIM

NR. 60, DATË 21.08.2020

PËR  
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “RADIO TELEVISIONI  
SARANDA” SH.P.K., PËR MARRJE LICENCE TRANSMETIMI AUDIO PRIVATE  
LOKALE “SARANDA IME RADIO”

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kërkues: Shoqëria “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k.

Objekt: Shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., për marrje licence transmetimi audio private lokale “Saranda Ime Radio”.

Baza Ligjore: Neni 19, pikat 1/b dhe 16, neni 61, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullorja “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 43, datë 29.05.2020 “Për përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënien e licencës të transmetimit audio analoge”,

VËREN:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 153, datë 18.07.2016, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 43, datë 29.05.2020 “Për përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënien e licencës të transmetimit audio analoge”, ka çelur garën e përzgjedhjes së kandidaturave për dhënien e licencës të transmetimit audio analoge në Bashkinë Sarandë.

Në vijim të njoftimit të AMA-s për çeljen e garës, shoqëria “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., ka depozituar aplikimin nr. 1938 prot., datë 13.07.2020, për marrje licence transmetimi audio private lokale “Radio Saranda”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit, rezulton se shoqëria “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., është regjistruar si e tillë në datën 27.06.2020.

Page | 2

Bazuar në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në datën 02.07.2020, vulosur në mënyrë elektronike për të dhënat e shoqërisë “RADIO TELEVISIONI SARANDA” sh.p.k., rezulton se:

- NIPT i subjektit është: M04301804A.
- Subjekti është regjistruar si i tillë në datën 27.06.2020. Forma e organizimit të subjektit është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, duke qenë në përputhje me kriteret përcaktuara në ligj dhe rregullore.
- Objekti i veprimtarisë është: “Media Audio Vizive”.
- Administrator: Thodhori Dukshi
- Ortak i shoqërisë: Thodhori Dukshi, me 100% kuotave.
- Emri tregtar: RADIO TELEVISIONI SARANDA. Email: [sarandatelevizion@gmail.com](mailto:sarandatelevizion@gmail.com); Tel: 0682094020

Komisioni të Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD), konstatoi se subjekti person fizik Thodhori Dukshi është licencuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot AMA) me vendimin nr. 551, datë 28.12.2006, për subjektin televiziv privat vendor “Tv Saranda”, për të ushtruar veprimtari në qytetin Sarandë.

Nga ana tjetër, KSHD, vëren se emri i propozuar nga aplikuesi, subjekti “Radio Saranda”, është i njëjtë me emërtimin e një subjekti tjetër audio që ushtron aktivitet në Bashkinë Sarandë, konkretisht subjektit person fizik Shkëlqim Hajno, i licencuar për subjektin audio “Radio Saranda”. Pas kërkesës së AMA-s me shkresën nr. 1938/1 prot., datë 12.08.2020, për ndryshimin e emrit të subjektit audio, shoqëria “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k. me shkresën nr. 2260 prot., datë 17.08.2020, ka njoftuar se emri i programit audio të tij do të jetë “Saranda Ime Radio”.

Në përfundim KSHD, i propozoi AMA-s dhënien e licencës private lokale të transmetimit audio analoge, shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., për subjektin audio “Saranda Ime Radio”, për të mbuluar me sinjal audio, Bashkinë Sarandë, për një periudhë prej 5 vjetësh.

Pavarësisht sa më sipër, AMA vëren se bazuar në nenin 19, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 97/2013, të sipërcituar, parashikohet: “1. Funksionet kryesore të AMA-s janë:  
b) lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar;...”





Duke qenë se, AMA është organ kolegjal i përbërë nga Kryetari dhe 6 anëtarë, për të miratuar dhënien e licencës së transmetimit audio private lokale nevojitet një shumicë e cilësuar prej 5 votash, shumicë, e cila nuk u plotësua gjatë votimit për aplikimin e shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k.,

## PËR KËTO ARSYE

### V E N D O S I:

1. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës, së transmetimit audio private lokale shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., për subjektin audio “Saranda Ime Radio”, për shkak të mungesës të kuorumit të nevojshëm ligjor për lëshimin e licencës.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar:</b>	<b>Gentian</b>	<b>SALA</b> 
<b>Zëvendëskryetar:</b>	<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b> 
<b>Anëtarë:</b>	<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b> 
	<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI (Kundër)</b> 
	<b>Suela</b>	<b>MUSTA (Nuk mori pjesë në votim)</b> 